

VENDIM
Nr. 701, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 569, DATË 6.10.2023, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR TË VITIT 2023 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË SAMITIT TË PROCESIT TË BERLINIT TË DATËS 16 TETOR 2023”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 569, datë 10.10.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në titull, pas fjalëve “... 16 tetor 2023 ...” shtohen “... dhe të Samitit të III të Diasporës, në datat 22–23 nëntor 2023 ...”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 51 000 000 (pesëdhjetë e një milionë) lekësh, përkatësisht, si më poshtë vijon:

a) 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekë për përballimin e shpenzimeve të organizimit në Tiranë të Samitit të Procesit të Berlinit, në datën 16 tetor 2023;

b) 9 000 000 (nëntë milionë) lekë për përballimin e shpenzimeve të organizimit në Tiranë të Samitit III të Diasporës, në datat 22–23 nëntor 2023.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku